



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.672/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelet e parashtruara nga Albanë Abazi - Murtezaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Skënderaj, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Skënderaj, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohen si të bazuara apelet ZL Anr 672/2017, ZL Anr 673/2017, ZL Anr 674/2017, ZL Anr 675/2017, ZL Anr 676/2017, ZL Anr 677/2017, ZL Anr 678/2017, ZL Anr 679/2017, ZL Anr 680/2017 të parashtruara nga Albanë Abazi - Murtezaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Skënderaj, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Skënderaj, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Skënderaj nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Skënderaj, për vendvotimet:

2101B/01R

2110B/02D

2105B/01R

2125B/01R

2101X/02R

2128B/01D

2109B/01D

2117B/01R

2110B/01R

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutive të votimeve në Vendvotimet si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 09.11.2017 ka pranuar 9 apele ZL Anr 672/2017, ZL Anr 673/2017, ZL Anr 674/2017, ZL Anr 675/2017, ZL Anr 676/2017, ZL Anr 677/2017, ZL Anr 678/2017, ZL Anr 679/2017, ZL Anr 680/2017, të parashtruara nga Albanë Abazi - Murtezaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Skënderaj, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Skënderaj, me të cilën kërkon që të bëhet rinumërimi i votave me arsyetimin se në vendvotime të ndryshme i mungojnë votat e saj dhe se nuk i janë numëruar të gjitha votat.

Parashtruesja e apelit kërkon nga PZAP-i që këto apele të pranohen si të bazuar dhe të vërtetohet gjendja e saktë faktike. Si prova materiale ka bashkangjitur formularët e rezultateve të kandidateve për vendvotimet e lartcekura.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar apelet dhe i ka trajtuar si një apel të evidentuar me ZL Anr. 672/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të gjitha ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe shkresat e tjera si dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

apelet janë të bazuara

Paneli gjeti se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, për faktin se pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës si dhe dëshmive të ofruara nga ankuesi që gjenden në shkresat e lëndës dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga vendimi i KQZ-së me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit për vendvotimet e lartcekura si më lart, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal në Skenderaj nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Skenderaj për vendvotimet e lartcekura, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim të bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.A.nr. 672/2017 me datën 11.11.2017

Kryesuese e Panelit
Rafet Haxhaj



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.